

Lëvizjet e shtetasve në Shqipëri

Gusht 2023

Tiranë, më 25 Shtator 2023: Hyrjet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj në territorin shqiptar, në muajin Gusht 2023, janë 2.861.545. Ky tregues rezulton me një rritje 16,9 %, krahasuar me Gusht 2022. Daljet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj nga territori i Shqipërisë, gjatë muajit Gusht 2023, janë 3.014.747, duke shënuar një rritje me 20,6 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.


Hyrjet e shtetasve

Në Gusht 2023, numri i shtetasve shqiptarë që kanë hyrë në territorin shqiptar është 838.791. Ky numër është rritur me 13,7 %, krahasuar me Gusht 2022.

Numri i shtetasve të huaj që kanë hyrë në territorin shqiptar është 2.022.754. Ky numër është rritur me 18.3 %, krahasuar me Gusht 2022.

Gjatë tetëmujorit 2023, numri i shtetasve të huaj që kanë hyrë në territorin shqiptar është 7.190.410. Ky numër është rritur me 26,9 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2022 (tab.1).

Fig. 1 Lëvizjet e shtetasve në Shqipëri, Gusht 2022- Gusht 2023



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

Për publikim 25/09/2023

Daljet e shtetasve

Daljet e shtetasve shqiptarë nga territori i Shqipërisë, gjatë muajit Gusht 2023 janë 842.940. Krahasuar me Gusht 2022, ky tregues është rritur me 8,9 %.

Daljet e shtetasve të huaj nga territori i Shqipërisë gjatë muajit Gusht 2023, janë 2.171.807. Krahasuar me Gusht 2022, ky tregues është rritur me 25,9 %.

Numri i shtetasve shqiptarë të dalë nga territori i Shqipërisë gjatë tetëmuajorit 2023, është 4.577.753, duke u rritur me 18,9 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë (tab1).

Tab. 1 Lëvizjet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj

Periudha	Gusht 2022	Gusht 2023	Ndryshimi vjetor %	Janar - Gusht 2022	Janar - Gusht 2023	Ndryshimi vjetor %
Hyrje gjithsej	2.447.981	2.861.545	16,9	9.272.249	11.747.352	26,7
Shqiptarë	737.940	838.791	13,7	3.605.128	4.556.942	26,4
Të huaj	1.710.041	2.022.754	18,3	5.667.121	7.190.410	26,9
Dalje gjithsej	2.499.071	3.014.747	20,6	9.377.503	11.414.228	21,7
Shqiptarë	773.884	842.940	8,9	3.849.396	4.577.753	18,9
Të huaj	1.725.187	2.171.807	25,9	5.528.107	6.836.475	23,7

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

Në Gusht 2023, rajoni me numrin më të lartë të hyrjeve të shtetasve të huaj në Shqipëri është rajoni i Evropës me 1.951.489 shtetas, pasuar nga Amerika dhe Azia Lindore /Paqësori, përkatësisht me 40.106 dhe 12.335 shtetas (tab.2).

Tab. 2 Hyrjet e shtetasve të huaj sipas rajonit

Periudha	Gusht 2022	Gusht 2023	Janar – Gusht 2022	Janar – Gusht 2023
Gjithsej	1.710.041	2.022.754	5.667.121	7.190.410
I . Afrika	650	1.319	2.769	7.345
II. Amerika	31.696	40.106	130.656	171.342
III. Azia Lindore dhe Paqësori	3.823	12.335	16.480	44.948
IV.Lindja e Mesme	11.167	8.547	33.626	34.454
V. Azia e Jugut	920	1.762	6.508	9.556
VI. Evropa	1.644.032	1.951.489	5.132.241	6.903.360
- Evropa Qëndrore / Lindore	121.203	163.238	324.570	477.089
- Evropa Veriore	44.724	77.895	189.018	270.958
- Evropa Jugore	1.371.849	1.528.631	4.208.701	5.476.179
- Evropa Perëndimore	93.173	155.688	346.326	533.723
- Evropa Lindore / Mesdheut	13.083	26.037	63.626	145.411
VII. Rajone të paspecifikuara	17.753	7.196	344.841	19.405

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

Në Gusht 2023, krahasuar me Gusht 2022, hyrjet e shtetasve të huaj janë rritur:

- për qëllime personale me 18,2 %;
- për qëllime pushime, vizitë tek të afërm, etj. me 22,5 %;
- për biznes dhe qëllime profesionale me 34,1 % (tab.3).

Tab. 3 Hyrjet e shtetasve të huaj sipas qëllimit

Periudha	Gusht 2022	Gusht 2023	Ndryshimi vjetor (%)	Janar - Gusht 2022	Janar - Gusht 2023	Ndryshimi vjetor (%)
Hyrje shtetas të huaj	1.710.041	2.022.754	18,3	5.667.121	7.190.410	26,9
I. Personale	1.701.527	2.011.338	18,2	5.599.233	7.102.617	26,8
1. Pushime, vizitë tek të afërm, etj.	1.556.248	1.906.761	22,5	5.328.262	6.745.450	26,6
2. Trajtime shëndetësorë	11	116	954,5	1.835	608	-66,9
3. Qëllime fetare	48	67	39,6	341	323	-5,3
4. Udhëtarë transit	145.220	104.394	-28,1	268.795	356.236	32,5
II. Biznes dhe profesionale	8.514	11.416	34,1	67.888	87.793	29,3

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

Metodologjia

Qëllimi i publikimit të hyrjeve dhe daljeve të shtetasve shqiptarë dhe të huaj sipas mënyrës së udhëtimit (me det, ajër, tokë dhe pikave kufitare) është matja e disa treguesëve statistikorë që lidhen me turizmin.

Përkufizime

Hyrjet: Përfshijnë të gjitha hyrjet e personave në pikat kufitare (me ajër, det dhe tokë).

Hyrjet janë një koncept që i referohet të gjitha mbërritjeve. Një person që viziton disa vende njëkohësisht gjatë një viti llogaritet çdo herë si një hyrje e re.

Daljet: Përfshijnë të gjitha daljet e personave nga pikat kufitare (me ajër, det dhe tokë).

Daljet masin fluksin e shtetasve që lënë vendin e referencës. Një person që lë vendin e referencës disa herë gjatë një viti llogaritet çdo herë si një dalje e re.

Vizitor: Për qëllime të statistikave të turizmit, termi “vizitor” nënkupton “një person që udhëton në një vend të ndryshëm nga vendi ku ai banon, për një periudhë më pak se 12 muaj dhe qëllimi kryesor i këtij udhëtimi në vendin e vizituar nuk është ai i një veprimtarie fitimprurëse”.

Qëllimi i udhëtimit të vizitorëve dhe turistëve përfshin vizita për:

Qëllime personale të cilat grupohen në:

1. Pushime, vizitë tek të afërm etj.;
2. Trajtime shëndetësore
3. Qëllime fetare;
4. Udhëtarë tranzit.

Kategoria e biznesit që përfshin të gjitha bizneset dhe aktivitetet profesionale jashtë ambjentit të zakonshëm.

Burimi i të dhënave: Të dhënat janë administrative dhe sigurohen nga Ministria e Punëve të Brendshme (Policia e Shtetit, Drejtoria e Kufirit dhe Migracionit).

Të dhënat janë paraprake dhe subjekt rishikimi të vazhdueshëm. Për më shumë referohu:

http://www.instat.gov.al/al/dokumentimi/cil%C3%ABsia-statistikore/Politika_e_Revizionimit_Statistikor.

Diferencat statistikore midis hyrje-daljeve të shtetasve Shqiptarë apo të huaj vijnë kryesisht nga:

- Ligjit nr.71/2016 “Për Kontrollin Kufitar”, neni 17 “Lehtësimi i verifikimeve Kufitare”, ku gjatë sezonit turistik apo fluksit të shtuar, në momentet e hyrjeve të shtetasve në kufi, nuk regjistron shtetasit në hyrje;
- Procedurat lehtësuese që aplikohen për banorët e zonave kufitare të cilët kalojnë kufirin për arsye të aktivitetit të tyre tregtarë, kur kalojnë disa herë brenda ditës, nuk regjistrohen në hyrje;
- Dy-shtetësia që zotërojnë një pjesë e mirë e Shqiptarëve të cilët në momentin e kalimit të kufirit mund të deklarojnë shtetësi të ndryshme në dalje nga ajo në hyrje, etj.